

# Internimi në Francë 1940 - 1946

Marie-Christine Hubert

Identifikimi i “ciganëve” dhe monitorimi i lëvizjeve të tyre | Urdhrat për vendbanime të obligueshme të „nomadëve” në rajhun e tretë | Internimi në zonën e papushtuar | Internimi në zonën e pushtuar | Pas çlirimit | Jeta ditore në kampe | Rastet e dëbimit nga kampet franceze të internimit

➤ Në Francë ishin dy qasje të ndryshme por paralele të të ashtuquajturës “çështje Cigane”. Qasja franceze e shfrytëzimit të internimit si një mënyrë për integrimin e “Tsiganes” (“Ciganëve”) në shoqëri triumfoi ndaj qasjes gjermane të internimit si hap të parë për vrasjen masive. Prandaj, romët e Francës, ndryshe nga ata që jetonin në vendet nën okupimin gjerman, nuk u asgjësuan në kampin e Auschwitz. Megjithatë, ata nuk i ikën persekutimit: familje të tëra u internuan në kampe speciale përgjatë tërë vendit, gjatë dhe pas okupimit.

## PARATHËNIE

Derisa në vitet e 1930-të në Gjermani e ashtuquajtura “çështje Cigane” shihej si një çështje e ndërlikuar, që përfshinte karakteristikat racore, sociale dhe kulturore, autoritetet franceze, edhe pse shfrytëzimin një traditë mirë të vendosur të indinjatës anti-“Cigane”, kishin një qasje pak a shumë sociale në nevojën e tyre për trajtimin e indinjatës anti-“Cigane”. Duke shmangur shfrytëzimin publik të kriterit racor, në vitin 1912 ata merrnin si të mirëqenë një kategori, “nomadët”, të cilët, edhe pse kurrë nuk u definua qartësisht, nënkuptonte “Ciganët”. Që nga atëherë jeta për romët në Francë u bë gjithnjë më e vështirë. Në vitin 1940 “Ciganët” e parë u internuan në kampe në pjesët e okupuara dhe jo të okupuara të vendit.

Rreth gjysma e popullsisë “Cigane” para luftës në Francë, diku rreth 13,000 njerëz, u internuan në kampe speciale në tërë vendin. Përveç që u internuan, ata vuain nga sëmundjet dhe uria dhe, në shumë raste, u rekrutuan për punë të dhunshme. Edhe pse nuk kishte të dhëna për dëbim masiv me baza racore deri në fund të luftës, madje as në pjesën e okupuar të Francës, së paku më shumë se 200 “Ciganë” të origjinës franceze u vranë në Sachsenhausen, Buchenwald dhe Auschwitz-Birkenau.


## KAMPET E INTERNIMIT PËR “CIGANËT” NË FRANCË GJATË LUFTËS BOTËRORE II

III. 1

(nga Jo Saville dhe Marie-Christine Hubert,  
nga Bulletin Association des Enfants Cachés,  
Nr. 8 mars 1998)

NB. Kampet tjera të internimit për Çifutët  
nuk tregohen në hartë

\* “Départements” si në atë periudhë



Identifikimi i “ciganëve” dhe monitorimi i lëvizjeve të tyre

Urdhrat për vendbanime të obligueshme të „nomadëve“ në rajhun e tretë

Internimi në zonën e papushtuar


Internimi në zonën e pushtuar



III. 2

“Nomadët” në kamp në Montreuil-Bellay (Département Maine-et-Loire), 1944. Ky ishte kampi më i madh i internimit për “nomadët” në Francë, me deri 1,000 të internuar.

(nga Hubert 1999, f. 76)



III. 3

Ligji dekretues i 6 prillit, 1940. Neni 1 thekson: “La circulation des nomades est interdite sur la totalité du territoire métropolitain pour la durée de la guerre.” (Qarkullimi i “nomadëve” ndalohet në Francë për kohëzgjatjen e luftës.)

(nga arkivat e Département Bouches-du-Rhône) (Detaj)

## IDENTIFIKIMI I “CIGANËVE” DHE MONITORIMI I LËVIZJEVE TË TYRE

Që nga shekulli i 15-të ka pasur romë në Francë, por ata prapë fituan vëmendjen zyrtare vetëm në fund të shekullit të 19-të. Ishte në këtë kohë kur romët e liruar nga skllavëria në Principatat e Rumanisë arritën në Francë dhe në pjesën tjetër të Evropës perëndimore. Shumë nga këta romë iu bashkuan tanimë numrit të konsiderueshëm të njerëzve shëtitës (romëve të tjerë, punëtorëve, sezonal, vagabondëve, tregtarëve udhëtues, lypësve, endacakëve) të cilët brodhën nëpër regjionet rurale në Francë në kërkim të një jete më të mirë gjatë periudhës së vështirësive ekonomike.

“Tsiganes” (“Ciganët”) posaçërisht njolloseshin. Ata u fajësuan për çdo krim të përfytyrueshëm – vjedhje, hyrje pa leje, mashtrim, kidnapim të fëmijëve madje edhe për shpërndarjen e sëmundjeve. Shtypi zmadhonte këto shkelje reale ose të supozuara, duke ndihmuar në përhapjen e një ndjenje të zmadhuar të pasigurisë në mendjet e njerëzve derisa, në të njëjtën kohë,

ligjet kundër bredhjeve dhe lypjeve u dëshmuar si joefektive në ndalimin e mënyrës shëtitëse të jetesës.

Në vitin 1895 qeveria bëri regjistrimin e të gjithë shëtitësve. U regjistruan më shumë se 400,000 njerëz shëtitës, 25,000 prej tyre “nomadë” që udhëtonin si grupe në karvanë. Duke u përballur me presion nga opinioni publik, ligjvënësit punuan prej vitit 1907 deri 1912 për hartimin e ligjeve të reja që kishin për qëllim identifikimin e shëtitësve dhe monitorimin e lëvizjeve të tyre.

Me 16 korrik, 1912, qeveria miratoi një ligj që në mënyrë të veçantë kishte për shënjestër romët, edhe pse iu adresojë të gjithë shëtitësve. “Loi sur l’exercice des professions ambulantes et la réglementation de la circulation des nomades” (Ligji mbi Ushtrimin e Profesioneve Shëtitëse dhe Kontrollin e Lëvizjes së Nomadëve) dallon tri kategori të njerëzve udhëtues: “tregtarët udhëtues”, “forains” (tregtarët udhëtues në tregje) dhe “nomadët”. Neni 3 i këtij ligji, që përcaktonte kategorinë e “nomadëve”, drejtpërdrejt kishte romët në shënjestër. Që nga ajo kohë e tutje autoritetet franceze përdorën vetëm një shprehje “nomadët” për të përfshirë romët

dhe “Ciganët” e të gjitha llojeve. [III. 4]

Kjo kategori e re administrative iu nënshtrua kufizimeve të shumta. Nga secili individ që ishte 13 vjeçar e përmbi kërkohesh që të bartte një “kartelë me të dhënat antropometrike” që përmbante të dhënat e statusit civil, dy fotografi (pamjet anësore dhe nga përpara), shenjat e gishtërinjve dhe informatat për karakteristikat fizike. Nëse ai ndalohej në ndonjë distrikt ai duhej ta vuloste kartelën nga zyrtari publik, si kur arrinte ashtu edhe kur shkonte. Kreu i familjes gjithashtu kishte një kartelë grupore që tregonte statusin civil të çdonjërit që udhëtonte me të. Automjetet kishin një targë speciale të regjistrimit. Të dhënat për “nomadët” tani mbaheshin në prefektura dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Autoritetet dinin se kush ishin ata dhe mund t’i monitoronin lëvizjet e tyre. [III. 5]

## URDHRAT PËR VENDBANIME TË OBLIGUESHME TË „NOMADËVE“ NË RAJHUN E TRETË

Me luftën, vesi u shtrëngua rreth romëve. Së bashku me komunistët dhe të huajt, ata në fakt ishin viktimat e para



III. 4

*“Ligji mbi Ushtrimin e Profesioneve Udhëtuese dhe Kontrollin i Lëvizjes së Nomadëve”  
“Pavarësisht nga nacionaliteti, të gjithë personë që udhëtonin në Francë që nuk kanë banim të përhershëm ose të vendosur dhe që nuk i përkasin ndonjëres nga kategoritë e kushtëzuara më lart do të konsiderohen nomadë, edhe nëse kanë pasuri ose pretendojnë të ushtrjnë ndonjë zejë. Këta nomadë duhet të mbajnë kartelën me të dhënat antropometrike.”*  
(përkthyer nga Gazeta Zyrtare e 19 korrikut, 1912)



III. 5

*Kartela me të dhëna antropometrike*  
(nga arkivat e Département Bouches-du-Rhône)

franceze të konfliktit. Të dyshuar për spiunë, ata gradualisht u përjashtuan nga shoqëria dhe në mënyrë efektive u dëbuan.

Me 22 tetor, 1939, një dekret ushtarak iu ndalonte udhëtimin në tetë “départements” të Francës perëndimore dhe kampimin në dy “départements” (Indre-et-Loire, Maine-et-Loire). Autoritetet ushtarake u thirrën në Nenin 4 të Ligjit mbi gjendjen e rrethimit që datonte nga 9 gushti, 1849, dhe që më parë ishte përdorur gjatë Luftës së Parë Botërore për të arsyetuar internimin e “Ciganëve” në “kampet e spastrimit” dhe “e kampet e të dyshuarve”.

Me 6 prill, 1940, një dekret legjislativ i lëshuar nga presidenti i republikës ua ndalonte shëtitësve udhëtimin kudo në Francën metropolitane gjatë kohëzgjatjes së luftës dhe i bëri t’i nënshtroheshin urdhrave obligues për vendbanim. Zyrtarisht, kjo masë kishte për qëllim zvogëlimin e reziqëve të spiunazhit; jo zyrtarisht qëllimi ishte t’i detyronte “Tsiganes” të vendoseshin. [III. 3]

Xhandarmëria fillimisht bëri regjistrimin e “nomadëve” që mbanin kartelat e të dhënave antropometrike. Prefekti pastaj publikoi një dekret që u kërkonte të bëheshin banorë në një ose

më shumë distrikte përkatëse. Pasi që nuk ishte miratuar buxheti për zbatimin e dekretit, “nomadët” u lejuan të lëviznin përreth brenda një radiusi të caktuar për të gjetur punë dhe mjete për sigurimin e jetesës së tyre. Pushtimi nga trupat gjermane në maj të vitit 1940 parandaloi zbatimin e këtij dekreti në gjithë vendin.

### INTERNIMI NË ZONËN E PAPUSHTUAR

Romët në Alsace-Lorraine, sikurse Çifutët, u dëbuan në zonën e papushtuar ku Qeveria shqiptoi urdhrat për vendbanim të obligueshëm (“assignations à résidence”) ndaj tyre ose i internoi në kampet që fillimisht ishin ndërtuar për strehimin e republikanëve spanjoll. Kështu që 376 “Ciganë” u mbajtën në kampin e Argelès-sur-Mer (Pyrénées-Orientales) me 30 tetor, 1940. Pastaj ata u transferuan në kampet e Barcarès dhe Rivesaltes dhe në nëntor të vitit 1942 në kampin e Saliers (Bouches-du-Rhône). [III. 6, 7]

Në pjesën tjetër të zonës së papushtuar urdhrat për vendbanim të obligueshëm mbetën standarde. Në realitet fati i romëve varej në dashamirësinë e


prefektëve, të cilët mund të internonin secilin “nomad” që ata e vlerësonin si të padëshirueshëm. Kështu që, në prill të vitit 1941, prefekti i Hautes-Pyrénées grumbulloi të gjithë “ciganët” e “département” në rrafshnaltën Lannemezan, dhe pastaj i vendosi në një spital të shkatërruar të siguruar nga xhandarmëria.

Në mes të tetorit të viti 1940 dhe gushtit të viti 1944 diku 1,400 “nomadë” u internuan në dy kampe në zonë të papushtuar, përmes vendimit të vetëm të Qeverisë Vichy. Pushtimi gjerman i zonës në nëntor të vitit 1942 nuk kishte ndikim në fatin e tyre.

### INTERNIMI NË ZONËN E PUSHTUAR

Me 4 tetor, 1940, Komanda e Lartë Gjermane në Francë urdhëroi transferimin e “Ciganëve” në zonën e pushtuar në kampe nën mbikëqyrjen e gardës policore franceze. Autoritetet franceze ishin përgjegjëse për organizimin e tërë operacionit, ndërsa gjermanët thjeshtë jepnin disa udhëzime: familjet nuk duhej të ndaheshin, fëmijët duhej të dërgoheshin në shkollë.

Nga mesi i tetorit “Feldkom-



mandanten" (marshallët e terrenit) iu dhanë prefektëve udhëzimet se si ta zbatonin urdhrin, duke veçuar njerëzit që iu interesonin: "Të gjithë personat e nacionalitetit francez ose të huaj të cilët nuk kanë një vendbanim të përhershëm dhe të cilët enden në regjionin e pushtuar në mënyrën cigane ("nomadët" dhe "forains"), pa marrë parasysh a janë në posedim të kartelës me të dhëna antropometrike ose kartelës personale të identitetit."

Ndryshe nga francezët, gjermanët i definonin "Ciganët" në aspekte shumë të gjera. Ata aplikuan kriterin racor, por edhe social. Personat nomadë dhe të vendosur, pa marrë parasysh nëse ishin të integruar në shoqëri apo jo, u përcaktuan si "Ciganë". Duke ditur se që nga viti 1912 francezët zyrtarisht i njohën personat të cilët mbanin kartelat e të dhënave antropometrike si "Ciganë", në vitin 1940 gjermanët u përpoqën të impononin përkufizimin e tyre të një "Cigani", por pa sukses.

Xhandarët zbatuan përkufizimin gjerman vetëm për shkak se kryenin arrestimet e tyre në bazë të dekretit prefektural të publikuar në "département" e tyre. Prefektët, të etur për ruajtjen e ligjshmërisë, kishin publikuar në urdhrë prefektural për internim që transformoi

urdhrin gjerman në një dekret ligjor francez. Në këtë mënyrë, nga pikëpamja e opinionit publik dhe të të burgosurve, përgjegjësia për internim binte vetëm në autoritetet franceze. Internimi i "Ciganëve" ishte një iniciativë gjermane e zbatuar nga autoritetet franceze.

Deri me 31 tetor, 1940, rreth 400 "nomadë" veç ishin internuar në gjashtë kampe në zonën e okupuar. Ritmi i internimit u përshpejtua pas publikimit të urdhrit gjerman të datës 22 nëntor, 1940, që ndalonte ushtrimin e profesioneve udhëtuese në 21 "départements" në Francën perëndimore. Në të njëjtën kohë romët u dëbuan nga zona bregdetare, së bashku me Çifutët dhe të huajt. Vetë gjermanët pastaj dëbuan dhe internuan të gjithë ata që i konsideronin si "Ciganë": "nomadët" të cilët mbanin kartelën me të dhënat antropometrike por edhe "forains", personat e vendosur publikisht të njohur si "Ciganë" dhe "asocialët" të tillë si bredhësit dhe endacakët tjerë.

Këto internime të shumta e bënë të nevojshme hapjen e kampeve më të strukturuar, për t'i pranuar "nomadët" e internuar në kampe që ishin vendosur në baza emergjente dhe për qëllime specifike në tetor 1940. "Nomadët" e mbajtur në Mérignac (Gironde) dhe Boussais

(Deux-Sèvres), për shembull, u dërguan në kampin Route de Limoges në Poitiers (Vjenë). Në fund të dhjetorit 1940 rreth 1,700 "nomadë" dhe "forains" u internuan në 10 kampe. [Illa. 8, 10-12]

Në Francën lindore kampet u hapën prej prillit të vitit 1941 e më tej. Në Département Doubs, romët u internuan në ish Kriporen Mbretërore në Arc-et-Senans, një ndërtesë që tani është vendndodhja e trashëgimisë botërore të UNESCO-s. Në Département Yonne, ata u mbajtën në një hajat të një stacioni të papërdorur hekurudhor në Saint-Maurice-aux-Riches-Hommes.

Në fund të vitit 1941, rreth 3,200 "nomadë" dhe "forains" u internuan në 15 kampe. Ato kryesoret ishin Jargeau (Loiret), Poitiers (Vjenë), Moisson-la-Rivière (Loire-Inférieure) dhe Coudrecieux (Sarthe).

Në nëntor të vitit 1941 gjermanët vendosën të riorganizonin këto kampe me qëllim të zvogëlimit të shpenzimeve, të lehtësonin presionin ndaj rojeve dhe t'i ndalonin shumë ikje. Sikurse "Zigeunerlager" (kampet "Cigane") në Gjermani ose Austri, këto kampe tani u organizuan në baza regjionale.

Kjo ishte prapavija për vendosjen e kampit më të madh internues për "nomadët", kampi Montreuil-Bellay

### KAMPI “EKSPUZUES” NË SALIERS (BOUCHES-DU-RHÔNE)

*Kampi në Saliers (Bouches-du-Rhône) ka një histori speciale për shkak se ishte krijuar si një instrument propagande. Në një përpjekje për t'i hedhur poshtë deklaratimet e shtypit zviceran dhe amerikan se shumë kundërshtarë të regjimit nazistë po vdisnin në internim në jug të Francës, qeveria vendosi të ndërtonte kampet “ekspozuese”.*

*Pas dështimit të kampeve në Noë dhe Récébédou ( kampet “spitalore” që shpejt duhej të mbylleshin për shkak të kushteve të këqija për të internuarit), në mars të vitit 1942 u vendos që të ndërtohet një kamp ekskluzivisht për “nomadët”. Me bazë në Camargue ku është një traditë e caktuar “Cigane”, i ngjante një fshati tipik të regionit. Edhe një herë ky dështim i dëshpëruar: dërrasat e shkelura të shndërruara në baltë sa herë që binte shi, kabinat e zvarritura me parazitë, etj. Të internuarit ikën në masë të madhe.*

III. 7



III. 8

*Hyrja kryesore për në Kampin Route de Limoges në Poitiers (Département Haute-Vienne)*

(nga Hubert 1999, f. 74)

(Maine-et-Loire). Në mes të prillit dhe qershorit 1942 të internuarit nga kampet në tri “départements” e ndryshme, Coudrecieux, Montlhéry dhe Moisdon-la-Rivière, u dërguan në kampin e Mulsanne (Sarthe). Me 3 gusht, 1942, 717 të internuar u transferuan në Montreuil-Bellay për t’iu bashkuar të internuarve që u zhvendosën nga dy kampe të tjera. Me 18 gusht shifrat u ngritën në 1,018 të internuar. [III. 2]

Në janar 1943 rreth 2,200 “nomadë” u internuan në tetë kampe. Zvogëlimi i shifrave kur kampet u riorganizuan është për shkak të lirimit të “forains”.

#### PAS ÇLIRIMIT

Transferet vazhduan edhe pas çlirimit. Me 19 janar, 1945, “nomadët” në Montreuil-Bellay u dërguan në dy kampe të tjera. Edhe pse disa u liruan, 734 “nomadë” ende mbaheshin në tri kampe. Në dhjetor 1945 kampet në Jargeau dhe Saint-Maurice më në fund u mbyllën dhe të internuarit e tyre u liruan.

Ndryshe nga viktimat tjera të forcave pushtuese, romët nuk u çliruan sistematikisht pas verës së vitit 1944, madje as pas 8 majit, 1945. Sikurse qe-

veria Vichy, autoritetet e reja franceze e shikonin internimin e “nomadëve” si një hap të parë drejt detyrimit për tu vendosur. Korrespondenca në mes të Inspektoratit të Përgjithshëm për Kampe dhe Inspektoratit të Përgjithshëm për Shërbime Administrative ishte mjaft e shfaqur: të dy palët u pajtuan që internimi duhet të zëvendësohej me urdhrat për vendbanim të obligueshëm. Kjo pjesë e trukut iu mundësoi autoriteteve të mbesin në kuadër të ligjit, pasi që dekreti që i nënshtroi “nomadët” ndaj urdhrave për vendbanim të obligueshëm ishte ende në fuqi.

Vetëm me ligjin e 10 majit, 1946, që caktoi datën statutores për ndërprerjen e armiqësive dhe në fakt shfuqizoi dekretin e 6 prillit, 1940, autoritetet u pajtuan të lironin romët pa kushte. Les Alliers, kampi i fundit i internimit për “nomadët”, u mbyll pastaj me 1 qershor, 1946.

Një azhurnim i shumë transferimeve— disa të internuar shërbyen në 4 ose 5 kampe— mundësoi rishikimin e numrit në rënie të romëve të internuar në Francë. Deri në vitin 1992 shifra e përafërt prej 30,000 pranohej gjerësisht. Deri te një shifër tjetër u arrit përmes kontrollimit të të dhënave në kampe që mbaheshin në arkivat “départemental”

dhe më saktësisht përmes analizimit të shifrave kamp për kamp. Duke pasur kujdes që të mos numëroheshin të njëjtit njerëz disa herë në llogaritëm shifrat prej 4,600 të internuarve në zonën e okupuar dhe 1,400 në zonën e lirë, që do të thotë një total prej 6,000 të internuarve. Marrë parasysh se disa të dhëna nuk janë të plota, mund të supozohet që në mes të 6,000 dhe 6,500 njerëzve u internuan si “nomadë” në 30 kampe franceze të internimit, ose përafërsisht gjysma e popullatës rome e pranishme në Francë në vitin 1939. [III. 1]

#### JETA DITORE NË KAMPE

Romët e Francës u internuan sipas urdhrave gjerman me bashkëpunimin e autoriteteve franceze dhe pëlqimin e shumicës së opinionit publik, që mbeti tërësisht indiferent ndaj fatit të njerëzve të internuar.

Më shumë se 90% të këtyre ishin të nacionalitetit francez. Shumë romë të huaj duket të kenë braktisur vendin me shpërthimin e luftës. Disa u internuan si të huaj në kampet e Francës jugore, siç ishin Gurët.

Një nga karakteristikat kryesore



III. 9

*Të internuarit “Ciganë” në kampin Rivesaltes.*

(nga Hubert 1999, f. 67)



III. 10

*Kasollet e përdorura për strehimin e “nomadëve” në kampin Route de Limoges në Poitiers (Vjenë).*

(nga Arkivat Nacionale, seksioni fotografik (NAps), F7 15109, 6 janar, 1942)

të internimit romë ishte se tërë familjet mbaheshin së bashku. Ndryshe nga Çifutët, meshkujt nuk ndaheshin nga gratë dhe fëmijët e tyre. Integriteti i grupit familjar respektohej plotësisht. Fëmijët përbënin 30–40% të të gjithë të internuarve.

Romët kaluan gjashtë vjet të burgimit në kushte të vuajtjeve më të mëdha. Shpesh kampet ndërtoheshin në ndonjë fushë ose shpat kodre në mëshirën e elementeve, si në Lannemezan. Ata pajiseshin dobët dhe pa kushte higjienike. Duke mos qenë të ndërtuara për këtë qëllim, ndërtesat shpejt u bënë të pabanueshme. Shtretërit nuk kishin më dyshekë ose batanije. Kasollet ishin të mbushura me miza dhe morra. Në Haute-Marne “nomadët” u internuan në një kala të pashfrytëzuar që më nuk kishte dyer, dritare apo ujë. Në Mulsanne kasollet ishin të mbuluara me hekur të zhubrosur, që ngriheshin gjatë dimrit dhe shumë të nxehtë gjatë verës. Aty ku mundeshin, romët preferonin të jetonin në karvanët e tyre sesa në kasollet të cilat ishin të ndotura dhe të papërshtatshme për mënyrën e tyre të jetesës.

Romët vuanin nga të ftohtit sepse ata nuk kishin më rroba. Këto ishin lënë në karvanët e tyre, të cilët zakonisht

braktiseshin në rrugë kur pronarët e tyre arrestoheshin. Duke mos pasur lëndë djegëse, të burgosurit në Moisdon-la-Rivière nuk kishin ndonjë mundësi përpos t’i digjinin dërrasat e dyshemesë të kasolleve të tyre për tu ngrohur.

Sipas shumë raporteve, ata gjithashtu ishin të uritur. Në disa kampe si në Coray (Finistère), administrata nuk furnizonte për ushqimin e tyre. Burrat punonin jashtë kampit ndërsa gratë dhe fëmijët qëndronin brenda, për t’i parandaluar burrat nga ikja. Gjetiu fondet e rezervuara ishin të pamjaftueshme ose arrinin vonë, posaçërisht gjatë disa muajve të parë.

Internimi ishte edhe më i vështirë për shkak se “nomadët” duhej ta përballonin vetvetiu. Ndryshe nga kategoritë e tjera të të burgosurve, ata nuk merrnin ndonjë ndihmë nga jashtë. Ata nuk mund të llogarisnin në familjet e tyre, të cilat gjithashtu ishin internuar ose ishin shumë të varfra për të ndihmuar, dhe ata nuk kishin ndihmë nga shoqata bamirëse që bënte shumë për kategoritë tjera të të burgosurve. Kështu ata nuk ishin në gjendje t’i plotësonin racionet e tyre, sikurse të burgosurit e tjerë. Vetëm Kryqi i Kuq, shoqata bamirëse Secours Nati-

onal dhe një ose dy shoqata religjioze arritën në ndihmën e tyre – në raste të izoluara. Përkundër gjithë kësaj, tretja e ashpër dhe të ënjturat aq të shpërndara gjetiu, këtu nuk ishin shumë të zakonshme. [Illa. 2, 6-13]

Internimi mund të mos ketë qenë një iniciativë e autoriteteve franceze, por ata e shfrytëzuan atë si një mënyrë për t’i futur “Tsiganes” në rrjedhat e shoqërisë. Fëmijët u dërguan në shkollë, zakonisht të kufizuar brenda kampit. Në kampet e Les Alliers dhe Saliers bonjakët dhe fëmijët e braktisur ose përkohësisht të ndarë nga prindërit e tyre u vendosën nën kujdesin e autoriteteve të mirëqenies ose institucioneve religjioze. Autoritetet mendonin se vetvetiu fëmijët do të mund të “shoqërizohen”, me kusht që nuk do të kishin kontakt të mëtejshëm me ambientin e tyre origjinal.

Për të rriturit, integrimi shoqëror ishte përmes punës. Përveç detyrave të tyre të zakonshme, të internuarit punonin për kompanitë private brenda vetë kampit. Të tjerët punonin jashtë kampit, në ferma dhe prona pyjore por gjithmonë të ruajtur nga disa xhandarë. Një pjesë e pagës së tyre ndalohej për të mbuluar shpenzimet e internimit të tyre.



III. 11  
*Infermeria e kampit në Mérignac (Gironde).*  
(nga NAs, F7 15099, 18 shkurt, 1942)



III. 12  
*Brendia e barakave në kampin Mérignac (Département Gironde).*  
(nga Hubert 1999, f. 74)

Gjermanët gjithashtu kërkonin këtë forcë punëtore për Organizatën Todt, e cila ndërtonte projekte madhore në vendet e okupuara, përfshirë Murin Atlantik, dhe më vonë Shërbimin e Punës së Obligueshme. Numri i kërkuar ishte relativisht i vogël sepse shumë të internuar iknin. Gjermanët gjithashtu hezitonin të merrnin forcën punëtore, që ata e vlerësonin si të “paaftë dhe përtace”.

Ishte shumë e vështirë për romët që ta fitonin lirinë. Ata duhej të posedonin një shtëpi ose të paraqitnin një dëshmi të certifikatës për akomodim, të pranoheshin nga lokaliteti vendas, të kishin një dosje të pastër të sjelljes nga kampi, të merrnin leje nga prefekti në distriktin e arritjes dhe shkuarjes së tyre dhe nganjëherë nga autoritetet gjermane. Posa liroheshin, ata i nënshtroheshin urdhrat për vendbanim të obligueshëm sipas dekretit të 6 prillit, 1940. Në raste shumë ekstreme, popullata lokale e cila nuk dëshironte romët në zonën e tyre, me sukses aplikonin për ri-internimin e tyre.

Romët bënë çmos që të iknin. Kampi në Arc-et-Senans u mbyll në shtator të vitit 1943 sepse shumë njerëz ikën nga atje.

#### RASTET E DËBIMIT NGA KAMPET FRANCEZE TË INTERNIMIT

Për një varg arsyesh nazistët kurrë nuk urdhëruan dëbimin e romëve të Francës në Auschwitz për asgjësim. Prandaj, nuk kishte dëbime masive me baza racore. Mirëpo, disa romë të internuar në Francë, u dëbuan në kampet e Sachsenhausen, Buchenwald dhe madje Auschwitz-Birkenau.

Me 13 janar, 1943, 70 meshkuj në moshën prej 16 deri 60 vjeçare u larguan nga kampi Route de Limoges në Poitiers, me sa duket, sipas komandantit të kampit, për të punuar në fabrika në Gjermani. Në fakt, këta romë kurrë nuk arritën në fabrikat gjermane. Ata u dërguan në kampin Royallieu në Compiègne para se të transferoheshin në Oranienburg-Sachsenhausen me 23 janar. Me 23 qershor edhe 25 meshkuj u dërguan në Compiègne. Me 26 qershor, 23 nga ta shkuan për Buchenwald. Pse? Si duket prefektura ua dorëzoi gjermanëve ashtu që punëtorët e rinj dhe të vendosur të kurseheshin. Posa gjermanët kuptuan që njerëzit të

cilët iu dërguan nuk ishin punëtorë të aftësuar, i dërguan në kampet naziste të përqendrimit.

Sipas raporteve të ndryshme që ende duhet të vërtetohen nga burimet tjera, ngjarjet në Poitiers nuk ishin të pazakonshme. Si duket që romët, të cilët i nënshtroheshin urdhrave për vendbanim të obligueshëm në zonat e papushtuara, u arrestuan nga autoritetet franceze dhe pastaj u dërguan që të plotësonin kuotat e punës të kërkuara nga gjermanët. Pastaj, sikurse romët nga kampi Poitiers, këta të pafat u dërguan në kampet naziste të përqendrimit dhe jo në fabrika në Gjermani.

Të dhënat e kampit për Auschwitz-Birkenau zbulojnë gjurmët e rreth 40 romëve belg dhe francez të internuar në Francë prej vitit 1940 deri në vitin 1943. Të arrestuar në periferi të Rouen (Seine-Inférieure), këta romë u internuan në Montlhéry dhe pastaj në Montreuil-Bellay. Në verë të vitit 1943 ata u liruan dhe iu dhanë urdhrat për vendbanim të obligueshëm afër kampit. Pastaj ata u kthyen në regjionin e tyre të origjinës ku u rrethuan nga gjermanët në vjeshtë të vitit 1943, u internuan në barakat Dossin në Me-



III. 13

*Kampi në Saint-Maurice-aux-Riches-Hommes (Yonne).* (nga NAs, F7 15110, qershor 1943)

chelen/Malines (Belgjikë) dhe pastaj u dëbuan në Auschwitz si pjesë e Konvojit Z me 15 janar, 1944. Ky konvoj përfshinte 144 romë francez.

Dëbimi u krye sipas “Dekretit të Auschwitz” të datës 16 dhjetor, 1942, sipas të cilit të gjithë “Ciganët” në Rajhun e Madh duhet të dëbohes-

hin në kampin e Auschwitz-Birkenau. Ky është dëbimi i vetëm i regjistruar nga territori francez i cili ishte bërë në baza racore.

## PËRFUNDIM

Romët e Francës i shpëtuan asgjësimit për shkak se Franca nuk ishte pjesë e Rajhut të Madh. Por ata nuk i shpëtuan internimit. Edhe pse u urdhërua nga autoritetet gjermane, internimi shihej si një mundësi e artë për arritjen e

qëllimit të parashtruar nga autoritetet franceze që nga fillimi i shekullit të 20-të, e që ishte detyrimi i romëve për tu vendosur, pasi që mënyra nomade e jetesës shihej si e vetmja gjë që i parandalonte nga integrimi i tyre në shoqëri.

Kështu autoritetet franceze shfrytëzuan internimin, së bashku me

masat që me gjasë do të inkurajonin “nomadët” të vendoseshin posa të largoheshin nga kampet: shkollim për fëmijë, punë të rriturit, mësimin e krishterë për të gjithë, dhe urdhrat për vendbanim të obligueshëm. Autoritetet në pushtet pas çlirimit vazhduan këtë politikë si një gjë e natyrshme.

## Bibliografia

**Filhol, Emmanuel (2004)** *La mémoire et l'oubli. L'internement des Tsiganes en France 1940-1946.* Paris: L'Harmattan | **Etudes Tsiganes (2/1995, Volume 6)** 1939-1946, France: *L'internement des Tsiganes* | **Hubert, Marie-Christine (with Peschanski, D. / Philippon, E.) (1994)** *Les Tsiganes en France 1939-1946.* Paris: CNRS Editions | **Hubert, Marie-Christine (1999)** *The internment of Gypsies in France.* In: Kenrick, Donald (ed.) *In the shadow of the Swastika. The Gypsies during the Second World War 2.* Hatfield: University of Hertfordshire Press, pp. 59-88 | **Kenrick, Donald / Puxon, Grattan (1974)** *Destins gitans. Des origines à la solution finale.* Paris: Calmann-Lévy | **Maximoff, Matéo (1993)** *Routes sans roulettes.* Romainville / Paris: Editions Matéo Maximoff | **Pernot, Mathieu (2001)** *Un camp pour les Bohémiens. Mémoires du camp d'internement pour nomades de Saliers.* Arles: Actes Sud